

VENDIM
Nr. 370, datë 30.1.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GOLEM TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Golem të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 110 (njëqind e dhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 773 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Golem për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Golem		Lidhja nr. 1
15	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
16-30, 64, 65, 66	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
54-63	Varrezat publike	Në pronësi
68 -663, 665- 672	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
676-677	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
696-699, 701-702, 704, 705, 707, 708, 710, 712-715, 717-720, 721, 723-725, 727, 729, 731	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorin Në zbatim të VKM-së nr. 567, datë 5.9.2007, ZMMT-ja e komunës Golem dhe DAMT-ja e qarkut Tiranë, ka vënë në dispozicion të AKKP-së sipërfaqen e tokës prej 232.74 ha. Në këtë sipërfaqe përfshihet dhe baza eksperimentale e shkollës së mesme Golem, gjithsej 10.62 ha, e cila në listën e inventarit ka numrin 696 (bashkëlidhur lista e pasurive që i kanë kaluar AKKP-së). Këto sipërfaqe nuk transferohen.

700, 703, 706, 709, 711, 716, 722, 726, 728, 733, 736, 738, 741, 742, 745, 747, 749, 752, 755, 761, 764, 767, 770	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
--	---	------------